

**THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT NGA TË GJITHA KOMUNAT
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PJESËMARRJE NË TREGUN MOBIL TË FERMERËVE NË
PRISHTINË**

Projekti i “Tregut mobil të fermerëve në Prishtinë”, i përkrahur nga Zyra e BASHKIMIT EVROPIAN në Kosovë dhe i implementuar nga KOMUNA E PRISHTINËS, ka si qëllim të përmirësojë kushtet për zhvillim ekonomik, për fermerët vendor me synim rritjen e qasjes së tyre në treg, stimulimin e zëvendësimit të importit, përmirësimin e furnizimit/ ofertës me produkte bujqësore vendore dhe promovimin e tyre, si dhe rivitalizimin e ekonomisë rurale në rajonin qendër.

1. QËLLIMI I THIRRJES PËR APLIKIM:

Qëllimi i thirrjes për aplikim është të ftojë të gjithë fermerët e Kosovës të marrin pjesë në projektin e “Tregut Mobil për Fermerë në Prishtinë”, respektivisht në tregun mobil të fermerëve në Prishtinë, në mënyrë që të rrisin qasjen e tyre në treg, të bëjnë promovimin e prodhimeve vendore si dhe të përmirësojnë njohuritë e tyre në prodhim, marketing dhe menaxhim të fermës, gjatë vitit 2016.

2. PËRFITUESIT:

Fermerë apo biznese (individë dhe subjekte juridike), shtetas të Kosovës, që janë të regjistruar në Regjistrin e Fermerëve, të cilët veprojnë dhe afrojnë në Kosovë. Fermerët duhet t’i përmbushin kushtet sipas kësaj thirrje për aplikim.

3. SEKTORËT DHE NËNSEKTORËT QË DO TË PËRKRAHEN:

Projekti për themelimin e tregjeve mobile të fermerëve në Prishtinë, i cili ka në fokus përkrahjen dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Rajonin Ekonomik Qendër do të përkrahë respektivisht fermerët që merren me:

- ✓ Kultivimin e frutave,
- ✓ Kultivimin e perimeve,
- ✓ Përpunimin e fruta-perimeve,
- ✓ Kultivimin e drithit (grurë, misër, elb, tërshërë etj.),
- ✓ Shpeztari, respektivisht kultivimin e pulave vojse,
- ✓ Bletari,
- ✓ Blegtori, specifikisht prodhimi i qumështit dhe nënprodukteve të tij,
- ✓ Lule, herba dhe bimë mjekuese si dhe çajra natyrale,
- ✓ Ushqimi i freskët, tekstil dhe suvenirë.



4. KRITERET PËR APLIKIM:

Kriteret e përgjithshme për kualifikimin e fermerëve për pjesëmarrje në këtë projekt, gjegjësisht në tregjet mobile në Prishtinë janë:

- ✓ Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- ✓ Të jenë të regjistruar në regjistrin e fermerëve;
- ✓ Të kenë të mbjellë së paku 0.20 ha sipërfaqe toke të mbjellë në fushë të hapur dhe ose së paku 2.4 ari tokë të mbjellë në serra;
- ✓ Të kenë së paku 50 litra qumësht në ditë. Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikul të Republikës së Kosovës ose me matrikul të vendeve anëtare të BE-së;
- ✓ Të kenë minimum 10 shoqëri bletësh (koshere). Kosheret duhet të jenë të shënuara me numër identifikues të pronës, sipas një rregullimi të brendshëm nga MBPZHR-ja;
- ✓ Të kenë minimum 2,000 krerë pula vojse ose të kenë prodhim të së paku 2000 vezëve në ditë. Dokumentacioni duhet të shoqërohet me një certifikatë të marrë nga veterineri;
- ✓ Lulishtet apo kultivuesit e herbave dhe bimëve mjekuese që kanë kapacitete prodhuese për qëllime komerciale, të cilat duhet të dëshmojnë me referencë;
- ✓ Të kenë së paku 5000 kg prodhim të fruta perimeve të përpunuara dhe certifikatat e AUVK-së dhe Institutit të Shëndetësisë dhe Higjenës së Kosovës;
- ✓ Plane për zgjerim të aktivitetit agrar.

5. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:

- ✓ Aplikacioni i plotësuar
- ✓ Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- ✓ Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- ✓ Kopjen e certifikatës së regjistrimit në Regjistrin e Fermerëve.
- ✓ Çertifikatat e kërkuara sipas pikës nr. 5 të kësaj thirrje

6. PERIUDHA E APLIKIMIT: Aplikimi zgjat prej momentit të shpalljes publike, nga data **XXX** Gusht 2016 deri më 30 Nëntor 2016.

7. MËNYRA E APLIKIMIT: Aplikimi bëhet në zyrat e "Gratë në Biznes", në Prishtinë.

Adresa: Rr. Zeki Shulemaja, Kati 1 /nr2-1, Prishtinë, Kosovë. Tel. +381 (0) 38 222 624

Formularin e aplikimit mund ta merrni në zyr e Gratë në Biznes ose mund ta shkarkoni në web-faqen e projektit:

www.tregu-pr.com

